



Data: 29/07/2019

Ref.: 1383/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Efiqenca e Energjisë, MA Profesional 60 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
 - Inxhinieria e mjedisit, BSc 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik
 - Gjeodezi, MSc 120 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik
- II. Obligohet Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës më datë 29.05.2019 me qëllim të vlerësimit të

programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Gabor Dombay dhe Prof. Dr. Laszlo Fulop.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se programet e studimit Eficienca e Energjisë (MA Profesional), Inxhinieria e Mjedisit (BSc) dhe Gjeodezi (MSc) të ofruara nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës përmbushin substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

